



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 783, Datë 12.03.2021

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inuteve bujqësore”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.03.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inuteve bujqësore.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003);
Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi monitorimin e tregut të importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inuteve bujqësore”,

VËREN SE :

1. Nisur nga shqetësimet e ngritura në media mbi rritjen e çmimit të plehrave kimike, bazuar në nenin 28, germa a), të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në datën 11 dhe 12 Mars 2021, procedoi me kryerjen e monitorimeve në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inuteve bujqësore, me qëllim vlerësimin e konkurrencës në këtë treg.
2. Nga vlerësimi i informacionit të grumbulluar gjatë monitorimit të kryer pranë ndërmarrjeve kryesore në tregun e importit dhe shitjes me shumicë, si dhe në ambjentet e Shoqatës së Tregtarëve Shqiptarë të Plerave Kimike dhe Inuteve Bujqësore “AFADA”, rezultoi se: disa ndërmarrje gëzojnë të drejta ekskluzive në tregtimin e produkteve të mbrojtjes së bimëve; ndërmarrjet kanë realizuar importe të përbashkëta dhe kanë siguruar gjendje të produkteve në magazina, duke i shitur ato

me çmime shumë më të lartë se kostot e blerjes së tyre. Në treg operojnë ndërmarrje të konsoliduara dhe me pjesë të konsiderueshme të tregut.

3. Për sa më sipër, ngrihen dyshime të arsyeshme se mes ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore ka elementë të një sjelljeje të bashkërenduar, e cila mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1 dhe nenit 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 8, nenin 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore.
2. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 janari 2020 deri në 31 mars 2021.
3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS